



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-005

PËR PËRDORIM CIVIL TË EKSPLOZIVËVE

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës , me qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për Përdorim Civil të Eksplozivëve,

Miraton këtë

LIGJ PËR PËRDORIM CIVIL TË EKSPLOZIVËVE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj rregullon kushtet dhe kriteret e prodhimit,tregimit,importit,eksportit,transitit, transferimit, deponimit, përdorimit dhe asgjësimit të eksplozivëve si dhe kushtet për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njeriut, pronës dhe mjedisit.

Neni 2
Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

“**Përdorimi civil i eksplozivëve**” nënkupton përdorimin e eksplozivëve nga personat juridik dhe institucionet tjera përveç atyre të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

“**Eksplozivet komercial**” konsiderohen materiet të cilat përdoren për rrenim ose ndryshim të formës së objekteve dhe materialeve me energjinë e liruar nga reaksioni kimik i zbrërthyesit të eksplozivit.

“Iniciuesit e eksplozivëve” konsiderohen të gjitha llojet e kapsollave, ndezësve dhe shkopinjeve (gajtanëve) si dhe mjetet piroteknike të cilat shfrytëzohen gjatë inicimit të eksplozivëve pa marrë parasysh mënyrën e aktivizimit para minimeve.

“Baruti” është eksploziv, i cili digjet me mjetet e përçueshmërisë termale dhe kryesisht përdoret si propeler i predhave.

“Produktet e mbushura me eksplozivë” nënkupton produktet të cilat përmbajnë ose janë të mbushura me eksplozivë, në të cilat bazohet efikasiteti i tyre

“Substancat piroteknike” substanca ose përzierje piroteknike që lirojnë nxehtësi, drite, gaz, mjegull ose tym, apo kombinimet e tyre që janë si pasojë e reaksioneve jo detonuese të vetë qëndrueshme dhe të reaksioneve kimike ekzotermike.

“Substancat eksplozive” janë substanca të ngurta ose të lëngëta apo përzierjet e tyre të gatshme për reaksion kimik që lirojnë gazra, temperaturë dhe shtypje shpejtësia e të cilave mund të shkatërroj ambientin.

“Ministria” nënkupton Ministrinë e Punëve të Brendshme.

“Tregtim” nënkupton qarkullimin juridik dhe fizik të eksplozivëve.

“Prodhim” nënkupton prodhim, përpunim ose modifikim i eksplozivëve.

“Furnizues” nënkupton personin juridik i cili nxjerr eksplozivët në treg.

“Përdorim i eksplozivëve” nënkupton trajtim të drejtpërdrejt ose aktivizim të eksplozivëve.

“Trajtim” nënkupton paketim, ngarkim, shkarkim, transferim dhe asgjësim të eksplozivëve.

“Deponim” nënkupton vendosjen e eksplozivëve në objekte të dizajnuara në mënyrë të veçantë ose hapësira të mbyllura .

“Import”- nënkupton çdo veprim i sjelljes së eksplozivëve në territorin e Kosovës.

“Eksport”- nënkupton çdo veprim të qitjes jashtë të eksplozivëve nga territori i Kosovës.

“Transit”- nënkupton çdo transferim i eksplozivëve përmes doganave të Kosovës nën mbikëqyrjen e zyrtarëve të doganave.

“Transferim”- nënkupton çdo veprim i lëvizjes fizike të eksplozivëve brenda territorit të Kosovës, përveç lëvizjes së eksplozivëve vetëm brenda një qyteti ose qyteze.

“Numri i KB-së” – nënkupton numrin identifikues dhe shkallën e rrezikshmërisë së materieve të rrezikshme, lehtë ndezëse dhe shpërthyesë të renditura në tabelën e Marrëveshjes Evropiane mbi Transportimin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme.

Neni 3 Eksplozivët

Materie eksplozive në kuptim të këtij ligji janë:

- i. Eksplozivët komercial;
- ii. Iniciuesit e eksplozivëve;

- iii. Baruti;
- v. Produktet e mbushura me eksplozivë;
- v. Substancat piroteknike; dhe
- vi. Lënda e parë me karakter eksploziv.

Neni 4 **Procedurat e atestimit te përshtatshmërisë**

Me dispozitat e këtij ligji përcaktohen procedurat për atestimin e përshtatshmërisë së eksplozivëve dhe kriteret për personelin i cili përdor eksplozivë.

Neni 5 **Dispozitat Përjashtuese**

Dispozitat e këtij ligji nuk vlejné për:

- i. autoritetet ushtarake dhe policore që përdorin eksplozivin për nevojat e tyre;
- ii. trupat e huaja ushtarake, që legalisht janë prezentë në territorin e Kosovës;
- iii. transportimin e eksplozivëve.

Neni 6 **Ministria**

Ministria lëshon licencat e prodhimit, importit, eksportit, transitit, tregtimit dhe transferimit të eksplozivëve, udhëheq procedurat administrative për përcaktimin e lokacioneve të ngarkimit , shkarkimit dhe asgjësimit të eksplozivëve jashtë objekteve të personit juridik.

KREU II

MASAT E SIGURISË, KRITERET TEKNIKE PËR EKSPLOZIVËT DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË PËRSHTATSHMËRISË

Neni 7 **Masat e Sigurisë**

7.1 Sipas dispozitave te këtij ligji , të gjitha masat e mbrojtjes së shëndetit, jetës së njeriut, pronës dhe mjedisit duhet të zbatohen gjatë përdorimit të eksplozivëve.

7.2 Personi juridik i përfshirë në veprimtarinë e prodhimit, të tregtimit, të përdorimit, të deponimit dhe të asgjësimit të eksplozivëve e garanton sigurinë e personave dhe të pronës, si

dhe i ndërmerr të gjitha masat e përcaktuara në Ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit e ambientit të punës dhe në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit.

7.3 Masat nga veprimtaria në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të definohen në dokumentacionin përkatës të paraparë në nenin 19 të këtij ligji.

7.4 Personat juridik duhet të përgatisin një plan të masave për rastet e aksidenteve ose rastet tjera emergjente si :eksplozim, zjarr dhe thyerje.

7.5 Personat juridik duhet të informojnë të gjithë personat e përfshirë në çfarëdo aktiviteti me eksplozivë, mbi masat e sigurisë të parashtruara në dokumentet e tij të përgjithshme, dhe në planin e tij të masave, dhe t'u siguron atyre trajnim për tu marrë me aksidentet dhe rastet tjera emergjente.

7.6 Objektet e planifikuara për prodhim, tregtim ose deponim të eksplozivëve duhet të jenë të sigurta fizikisht dhe teknikisht si dhe duhet të jen jashtë zonave të banuara.

7.7 Personi juridik i përfshirë në aktivitetin e përdorimit të eksplozivëve në çfarëdo mënyre, organizon dhe mbikëqyrë ekzekutimin e masave dhe kushteve të përshkruara.

7.8 Personi juridik i përfshirë në aktivitetin e prodhimit, të tregtimit ose të përdorimit të eksplozivëve është i obliguar që menjëherë ta informojë stacionin më të afërt policor për llojin dhe sasinë e eksplozivit të humbur ose të vjedhur.

Neni 8 Përdorimi fillestar

8.1 Eksplozivi mund të nxirret në treg dhe në përdorim, pasi prodhuesi ose furnizuesi të kenë marrë pëlqimin paraprak dhe udhëzimet për përdorim dhe asgjësim të sigurt nga Ministria.

8.2 Prodhuesi ose furnizuesi duhet të kenë dorëzuar dokumentin e përshtatshmërisë në organin kompetent.

8.3 Udhëzimet nga paragrafi 1 i këtij neni, hartohen në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.

Neni 9 Kriteret Teknike

9.1 Eksplozivët mund të nxirren në treg dhe në përdorim vetëm nëse :

- i. janë në pajtim me kriteret teknike të legjislacionit në fuqi dhe standardet ndërkombëtare;
- ii. është konstatuar përshtatshmëria e tyre në pajtim me procedurën e përshkruar në legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare;
- iii. janë të etiketuar në gjuhët zyrtare të Kosovës në mënyrë të përshtatshme dhe sipas standardeve ndërkombëtare.

9.2 Eksplozivët të cilët përmbushin kriteret nga paragrafi 1 i këtij neni vendosen në listën e eksplozivëve nga Ministria. Lista publikohet në Gazetën Zyrtare.

9.3 Ministria merr mostrat e eksplozivëve në treg për të kryer ekzaminimet e rregullta dhe të parregullta për të konstatuar përshtatshmërinë e tyre.

9.4 Ministria mund të merr mostra të eksplozivëve për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre me kriteret e përshkuara teknike. Në rast se përdorimi i mëtutjeshëm i një eksplozivi, paraqet rrezik për jetën e njerëzve ose për mjedisin, Ministria përkohësisht mund të ndalon tregtimin e eksplozivëve derisa të bëhet vlerësimi i përshtatshmërisë.

9.5 Nëse mostrat e marra nuk janë në përputhje me kriteret e përshkuara teknike, Ministria e ndalon tregtimin e atyre eksplozivëve.

9.6 Prodhuesi ose furnizuesi mbulon shpenzimet e ekzaminimit.

Neni 10

Vlefshmëria e Dokumenteve të Huaja të Përshtatshmërisë

10.1 Dokumentet dhe shenjat e huaja të përshtatshmërisë janë të vlefshme në territorin e Kosovës, nëse janë lëshuar në bazë të rregulloreve teknike dhe procedurave të lëshimit në agjencitë të cilat e bëjnë përshtatshmërinë dhe nëse janë në harmoni me ato në përdorim në territorin e Kosovës.

10.2 Ministria përcakton kriteret teknike për eksplozivët dhe procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë të renditura në nenin 9 të këtij ligji, si dhe procedurën dhe kriteret për pranimin e dokumenteve të huaja të përshtatshmërisë.

KREU III

KRITERET E PËRGJITHSHME

Neni 11

Kriteret e Përgjithshme

11.1 Çdo person i cili shfrytëzon eksplozivët duhet të përmbush kriteret si më poshtë:

- i. të paktën të jetë i moshës 21 vjeçar;
- ii. të mos ketë kufizim të aftësisë së veprimit;
- iii. nuk është duke u zhvilluar procedurë penale e cila ndiqet me detyrë zyrtare;
- iv. të mos jetë i evidentuar si përdorues i substancave narkotike dhe psikotrope;

v. profesionalisht të jetë i kualifikuar.

11.2 Kur procedura penale për ndonjë vepër penale të paraparë në nën paragrafin iii. të paragrafit 1 të këtij neni është në zhvillim e sipër, vendimi rreth përmbushjes së kriterëve shtyhet derisa vendimi në procedurë penale të bëhet përfundimtar.

Neni 12 Kualifikimi Profesional

12.1 Kualifikimi profesional në përputhje me paragrafin 2 të nenit 34 të këtij ligji është i domosdoshëm për personat të cilët angazhohen në aktivitetet e tregtimit dhe përdorimit me eksplozivë.

12.2 Personat të cilët nuk kanë kualifikim profesional mund të bartin, ngarkojnë ose shkarkojnë eksplozivët, vetëm nën mbikëqyrjen e personit profesionalisht të kualifikuar i cili është i obliguar të informoj paraprakisht për rreziqet e mundshme dhe për mënyrën e sigurt të punës.

KREU IV

KRITERET E VEÇANTA

NËNKREU 1

Prodhimi i Eksplozivëve

Neni 13 Kriteret

13.1 Eksplozivë mund të prodhojnë personat juridikë që kanë të punësuar personel profesionalisht të kualifikuar dhe i përmbushin kriteret e parapara me këtë Ligj.

13.2 Personat juridik mund të prodhojnë vetëm eksplozivët që kanë kaluar vlerësimin e përshtatshmërisë dhe që plotësojnë kriteret e përshkruara teknike.

Neni 14 Licenca për Prodhimin e Eksplozivëve

14.1 Personi juridik mund të fillojë prodhimin e eksplozivëve pasi të jetë lëshuar licenca për prodhim të eksplozivëve nga Ministria.

14.2 Licenca për prodhimin e eksplozivëve vlen 10 vjet nga data e lëshimit dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes me qëllim të sigurimit, të mbrojtjes së shëndetit dhe të jetës së njerëzve, të mbrojtjes së pronës dhe të mjedisit.

14.3 Kërkesa për licencë për prodhim të eksplozivëve përmban:

- i. emrin dhe adresën e personit juridik;
- ii. e dhënat personale për personat përgjegjës të personit juridik;
- iii. leja e punës për përdorim të objektit;
- iv. dëshmi të përmbushjes së kriterëve nga neni 9 paragrafët 1,2,3,4 ,5 dhe 6 të këtij ligji;
- v. të dhënat për llojet e eksplozivëve të cilët planifikohen të prodhohen;
- vi. të dhënat për procesin dhe teknologjinë e prodhimit.

14.4 Në kuadër të licencës së lëshuar për prodhim, eksplozivi i prodhuar i nënshtrohet testimit pas 6 muajve në vitin e parë dhe vazhdon për çdo 12 muaj.

Neni 15

Revokimi i Licencës për Prodhim

15.1 Licenca për prodhimin e eksplozivëve revokohet nëse personi juridik:

- i. nuk i përmbahet kriterëve të përcaktuara me këtë ligj;
- ii. nuk e ushtron veprimtarinë e prodhimit të eksplozivëve brenda një viti nga lëshimi i licencës për prodhim të eksplozivëve, ose ndërpret aktivitetin për më shumë se dy vite.

15.2 Të gjitha evidencat, të cilat mbahen në bazë të dispozitave të këtij ligji, i dërgohen Ministrisë nga personi juridik, jo më vonë se 8 ditë pasi vendimi për revokim të jete bërë i plotfuqishëm.

Neni 16

Prodhimi i Eksplozivëve në Vend-punishte

16.1 Personi juridik mund të prodhojë dhe përdorë eksplozivët në vend-punishte nëse ka në dispozicion pajisjet e nevojshme të specializuara dhe nëse i është lëshuar licenca për prodhimin e eksplozivëve nga Ministria.

16.2 Përveç të dhënave nga nën paragrafët i. dhe ii. të paragrafit 3 të nenit 14 të këtij ligji kërkesa për prodhim të eksplozivëve në vend-punishte duhet të përfshin:

- i. tipat e eksplozivëve të cilët planifikohen të prodhohen në vend-punishte;
- ii. specifikat teknike dhe dokumentet rreth vetive të sigurisë së eksplozivëve;
- iii. procesin teknologjik të prodhimit;
- iiii. certifikatat e kualifikimeve profesionale të personelit;
- iv. specifikat teknike të pajisjeve;
- v. përshkrimin e sistemit të menaxhimit të kualitetit.

Neni 17

Hulumtimet për prodhimin e eksploziveve

Hulumtimet për prodhimin e tipave të rinj të eksplozivëve ndërmerren nga prodhuesit e eksplozivëve dhe institucionet kërkimore, kur të sigurohen masat teknike dhe të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve, mbrojtjen e pronës dhe mjedisit.

Neni 18

Informimi

18.1 Poseduesit e licencës për prodhimin e eksplozivëve obligohen ta informojnë Ministrinë për çdo fillim ose ndërprerje të procesit të prodhimit të eksplozivëve.

18.2 Poseduesit e licencës nga paragrafi 1 i këtij neni obligohen që paraprakisht ta njoftojnë Ministrinë për çdo ndryshim në procesin e prodhimit të eksplozivëve.

Neni 19

Dokumentacioni për Eksplozivët

19.1 Për çdo tip të eksplozivëve, prodhuesi mban :

- i. deklaratën e përshtatshmërisë;
- ii. specifikat teknike;
- iii. udhëzimet për përdorim, deponim dhe asgjësim;
- iv. etiketën e klasës së produkteve të eksploziveve- piroteknike;
- v. tabelën e të dhënave mbi sigurinë.

19.2 Eksplozivët nxirren në treg, në paketimin e tyre origjinal, të cilët testohen dhe shënohen në pajtim me ligjin për transportim të mallrave të rrezikshme.

19.3 Përveç të dhënave të përcaktuara në ligjin për transportimin e mallrave të rrezikshme, çdo njësi e paketuar duhet të përmban informatat e më poshtme:

- i. data e prodhimit dhe data e skadimit të afatit;
- ii. udhëzimet për përdorim;
- iii. vërejtjet e veçanta.

NËNKREU 2

Tregtimi

Neni 20

Licenca për Shitje të Eksplozivëve

20.1 Personi juridik fillon aktivitetin e shitjes së eksplozivëve pasi ti jetë lëshuar licenca për tregtimin e eksplozivëve nga Ministria.

20.2 Licenca për shitje të eksplozivëve vlen 2 vjet nga data e lëshimit.

20.3 Kërkesa për licencën e shitjes së eksplozivëve përfshin:

- i. emrin dhe adresën e personit juridik;
- ii. të dhënat personale për personat përgjegjës të personit juridik;
- iii. dëshmi të përmbushjes së kriterëve nga neni 9 paragrafi 1,2,3,4,5 dhe 6 të këtij ligji;
- iv. dëshmi të përshtatshmërisë së objektit dhe pikës afariste të dedikuar për shitje të eksplozivëve.

20.4 Licenca për Shitje të Eksplozivëve revokohet nëse personi juridik :

- i. nuk i përmbahet kriterëve të përcaktuara me këtë ligj;
- ii. ndërpret angazhimin në aktivitetin e shitjes së eksplozivëve në pajtim me këtë ligj.

20.5 Të gjitha evidencat të cilat duhet të mbahen sipas dispozitave të këtij ligji, i dërgohen Ministrisë nga personi juridik, jo më vonë se 8 ditë pasi vendimi i revokimit të licencës për shitje të jetë bërë i plotfuqishëm.

Neni 21

Licenca për Blerje të Eksplozivëve

21.1 Licencën për blerje të eksplozivëve mund ta merr personi juridik i cili ka licence të tregtimit të eksplozivëve.

21.2 Licenca për blerje të eksplozivëve vlen 1 vit nga data e lëshimit.

21.3 Kërkesa e licencës për blerje të eksplozivëve përfshin të dhënat si më poshtë:

- i. emrin dhe adresën e personit juridik;
- ii. emrin dhe adresën e shitësit;
- iii. emrin, prodhuesin dhe tipin e eksplozivëve;
- iv. arsyen për blerjen e eksplozivëve;
- vi. kohën, vendin dhe mënyrën e përdorimit të eksplozivëve;

vi. projekt të hollësishëm të një eksperti për punët e planifikuara dhe sasinë e eksplozivëve të nevojshëm;

vii. të dhëna të tjera që janë të domosdoshme për shfrytëzim të sigurt të eksplozivëve.

21.4 Në rast se leja për blerje dhe përdorim kërkohet me qëllim të përdorimit të eksplozivëve në miniera apo shkatërrim të objekteve, nevojitet pëlqimi paraprak nga organet përgjegjëse.

21.5 Në zbatim të këtij Ligji, Ministria kompetente për Miniera me akte nënligjore i rregullon kushtet dhe mënyrën e përdorimit të eksplozivave në miniera.

Neni 22 Përdorimi i Eksplozivëve

Personat juridik mund të përdorin eksplozivët vetëm në lokacionet dhe për qëllimet e përcaktuara në licencën për blerjen e eksplozivëve.

NËNKREU 3 Importimi, Eksportimi dhe Transiti i Eksplozivëve

Neni 23 Licenca për Importim, Eksportim dhe Transit të Eksplozivëve

Importimi, Eksportimi dhe Transiti i eksplozivëve mund të behët vetëm nga personat juridik të cilët kanë licence për tregtim nga Ministria

Neni 24 Kërkesa për Licencë për Importim, Eksportim dhe Transit

24.1 Kërkesa për licencë për importim,eksportim dhe transit përmban:

- i. emrin dhe adresën e personit juridik;
- ii. emrin e eksplozivit dhe numrin identifikues (numri i KB-së);
- iii. emrin e prodhuesit;
- iv. emrin dhe adresën e shitësit ose dërguesit të eksplozivit dhe emrin dhe adresën e blerësit ose pranuesit të eksplozivit;
- v. emrin dhe adresën e vozitësit të automjetit, tipin e automjetit dhe numrin e targave të automjetit;
- vi. sasinë e eksplozivëve;
- vii. tabelën e të dhënave të sigurisë;
- viii. informatat identifikuese të municionit;
- ix. datën dhe kohën e importit, eksportit dhe transitit;

- x. kohën dhe vendin e ndalesave të pritshme;
- xi. kalimin kufitar hyrës dhe dalës dhe rrugën e transportit;
- xii. licencën e importit ose transitit të vendit në të cilin eksplozivët janë duke u eksportuar ose përmes së cilit është duke u bërë transiti i eksplozivëve; dhe
- xiii. kushtet adekuate për transport në pajtim me normat ndërkombëtare.

24.2 Personi juridik mund të importon ose eksporton eksplozivë vetëm me kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

24.3 Ministria përcakton masa të veçanta të sigurisë për import, eksport ose transit nëpër territorin e Kosovës.

24.4 Personat që transportojnë eksploziv janë të obliguar që ta kenë me vete Licencën për Importim, Eksportim dhe Transit dhe ta prezantojnë me kërkesën e policisë.

NËNKREU 4 **Transferimi**

Neni 25 **Transferimi i Eksplozivëve**

25.1 Licenca për transferim jepet pas aprovimit të kërkesës nga Ministria.

25.2 Personi i pajisur me licencën nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të ketë licencën për tregtim.

25.3 Kërkesa për licencë për transferim përfshihen të dhënat si më poshtë:

- i. emrin dhe adresën e personit juridik;
- ii. emrin e eksplozivit dhe numrin identifikues (numri i KB-së);
- iii. emrin e prodhuesit;
- iv. emrin dhe adresën e shitësit ose dërguesit të eksplozivit dhe emrin dhe adresën e blerësit ose pranuesit të eksplozivit;
- v. emrin dhe adresën e vozitësit të automjetit, tipin dhe numrin e targave të automjetit;
- vi. sasinë e eksplozivëve;
- vii. informatat identifikuese të municionit;
- viii. datën dhe kohën e transferimit;
- ix. kohën dhe vendin e ndalesave të pritshme,
- x. itinerarin e transportit,

25.4 Masat e veçanta të sigurisë, të cilat janë në fuqi në vendin përmes së cilit bëhet transferimi, duhet të ceken në licencën për transferim.

25.5 Personat të cilët janë duke transferuar eksplozivët obligohen që licencën për transferim ta kenë me vete dhe duhet ta prezantojnë me kërkesën e policisë.

25.6 Licenca për transferim mund të revokohet për arsye të sigurisë nga organi i cila e ka lëshuar atë.

Neni 26

Kufizimet mbi Transferimin e Eksplozivëve

26.1 Në rast të rrezikimit të sigurisë publike dhe për të parandaluar posedimin dhe përdorimin ilegal të eksplozivëve, Ministria mund të kufizoj ose të ndaloj transferimin e eksplozivëve.

26.2 Ministria përkohësisht mund të kufizon ose ndalon transferimin e eksplozivëve në tere territorin, ose në një pjesë të territorit të Kosovës, më qëllim të ruajtjes së sigurisë publike.

NËNKREU 5

Posedimi dhe Asgjësimi i Eksplozivëve

Neni 27

Posedimi i Eksplozivëve

Personi juridik ka te drejte te posedoj eksplozive nëse ka licencë te përcaktuar me këtë ligj.

Neni 28

Masat e Veçanta për Përdorim, Kthim dhe Asgjësim të Eksplozivëve

28.1 Personi juridik, nëse përdor eksplozivët në afërsi të rrugëve, hekurudhave, aeroporteve, naftësjellësve, gazsjellësve, ujësjellësve, linjave elektrike, linjave telefonike ose të infrastrukturës së ngjashme, duhet të marrë pëlqimin e Ministrisë dhe të informoj menaxherin e infrastrukturës përkatëse me shkrim se paku 7 dite para përdorimit të planifikuar si dhe të siguroj mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve, mbrojtjen e pronës dhe mjedisit.

28.2 Përgjithësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në raste të veçanta Ministria mund të vendos ndryshe.

28.3 Eksplozivët mund të asgjësohen vetëm në lokacionet ku lejohet asgjësimi i eksplozivëve, në sasi që nuk tejkalojnë 50 kg, në pajtim me udhëzimet e prodhuesit.

28.4 Eksplozivët asgjësohen vetëm nga personeli profesionalisht i kualifikuar, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria.

28.5 Ministria dhe komuna informohet për mënyrën, sasinë dhe vendin e shkatërrimit të eksplozivëve, së paku 7 ditë para shkatërrimit të planifikuar.

28.6 Eksplozivët e papërdorur në vend-punishite duhet të kthehen përsëri në depo.

NËNKREU 6

Objektet e prodhimit dhe deponimit

Neni 29

Kriteret e objekteve të prodhimit dhe deponimit

29.1 Objektet e prodhimit dhe të deponimit duhet të ndërtohen dhe të pajisen në mënyrë që të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve, pronës dhe mjedisit.

29.2 Eksplozivët deponohen në objekte të veçanta statike apo lëvizëse të dedikuara për deponim.

29.3 Objektet e prodhimit dhe të deponimit duhet të jenë të sigurta kundër qasjes së paautorizuar.

29.4 Në mënyrë të hollësishme me akte nënligjore përcaktohen kriteret për objektet për prodhim dhe deponim dhe kriteret për lokacionet për ngarkim dhe shkarkim të eksplozivëve.

Neni 30

Lokacionet për Ngarkim dhe Shkarkim të Eksplozivëve

Lokacionet për ngarkim dhe shkarkim të eksplozivëve jashtë objekteve të prodhuesit apo furnizuesit përcaktohen nga Ministria në pajtim me komunën.

KREU V

SUBSTANCAT PIROTEKNIKE

Neni 31

Prodhimi,deponimi,tregtimi, dhe transportimi i substancave piroteknike do të behët në mënyrën siç vepron me eksploziv ,ashtu siç është përcaktuar në kreun IV të këtij ligji.

Neni 32

Objektet ku do të deponohen dhe shiten substancat piroteknike, duhet ti plotësojnë kriteret e posaçme teknike dhe të sigurisë, të cilat përcaktohen nga Inspektori i parandalimit të zjarrit si parakusht për nxjerrjen e lejes nga organi kompetent për vënien në funksion të objektit.

Neni 33

Ministria do të nxjerr akt nënligjor ku do të përcakton mënyrën e prodhimit, tregimit dhe transportit të substancave piroteknike.

KREU VI

PERSONAT PËRGJEGJËS

Neni 34

Detyrat e Personave Përgjegjës

34.1 Personat përgjegjës, brenda kompetencave të tyre dhe përgjegjësive të përshkruara, sigurojnë prodhim, tregtim, përdorim, trajtim dhe asgjësim të sigurt të eksplozivëve në pajtim me dispozitat ligjore për eksplozivët, për të siguruar mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve, pronës dhe mjedisit..

34.2 Tregtimi dhe përdorimi i eksplozivëve u lejohe vetëm personave profesionalisht të kualifikuar. Kualifikimi dëshmohe me certifikatë të kualifikimit e cila është e vlefshme për 3 vite.

34.3 Arsimimi, kriteret e kualifikimit profesional dhe programet e trajnimit profesional përshkruhen më akte e nënligjore nga Ministria.

KREU VII

KONFISKIMI I EKSPLOZIVËVE

Neni 35

Konfiskimi i Eksplozivëve

Zyrtari i policisë në pajtim me legjislacionin penal në fuqi, konfiskon përkohësisht eksplozivët pa urdhëresë me shkrim nëse:

- i. personi në posedim nuk i tregon licencën e vlefshme;
- ii. personi është duke përdorur eksplozivët pa licencë;
- iii. personi është duke përdorur eksplozivët në kundërshtim me licencën .

KREU VIII

EVIDENCA

Neni 36 Mbajtja e Evidencave

36.1 Ministria, me qëllim të posedimit të të dhënave mban:

- i. evidencat për licencat e dhëna për prodhim, tregtim, import, eksport, transit, transferim dhe përdorim;
- ii. evidencat për licencat e revokuara të prodhimit, tregtimit, importit, eksportit, transimit, transferimit dhe përdorimit;
- iii. evidencat për mostrat e marra të eksplozivëve;
- iv. evidencat e eksplozivëve me udhëzimet për përdorim, për të cilat është dhënë pëlqimi nga Ministria.

36.2 Personi juridik i cili është prodhues i eksplozivëve mban evidenca për tipet dhe sasi të eksplozivëve të prodhuar, të shitur dhe të shkatërruar.

36.3 Personi juridik që është i/e angazhuar në aktivitetin e tregtimit, importit, eksportit, transimit, transferimit dhe përdorimit të eksplozivëve mban evidenca për tipet dhe sasi të eksplozivëve të blerë, të shitur, të asgjësuar dhe të kthyer.

36.4 Evidencat nga paragrafi 1 dhe i 2 i këtij neni mbahen për 10 vite, ndërsa evidencat nga paragrafi 3 i këtij neni mbahen për 5 vite.

36.5 Mënyra e mbajtjes së evidencave, formati dhe përmbajtja e të dhënave përshkruhen me akt nënligjor nga Ministria.

Neni 37 Mënyra e Mbledhjes së të Dhënave

37.1 Nëse nuk rregullohet ndryshe me këtë ligj, për mënyrën e mbledhjes së të dhënave zbatohen dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

37.2 Ministria mbledh të dhëna drejtpërdrejt nga personat juridik dhe zyrtarët kompetentë.

37.3 Ministria përdor të dhënat mbledhura për kryerjen e detyrave të definuar me këtë ligj.

37.4 Keqpërdoruesit e të dhënave nga ky nen përgjigjen në pajtim me legjislacionin penal në fuqi.

KREU IX

DETYRAT E ORGANEVE MBIKËQYRËSE

Neni 38

Kompetenca

Ministria është përgjegjëse për:

- i. dhënien e udhëzuesit dhe pëlqimit për përdorim të eksplozivëve;
- ii. udhëheqjen e procedurave administrative dhe dhënien e licencave të eksplozivëve për prodhim, import, eksport, transit, tregtim dhe përdorim;
- iii. bashkëpunimin për përgatitjen e njohurive profesionale dhe aftësitë standarde të personelit, të cilët kërkohen që të jenë profesionalisht të kualifikuar sipas këtij ligji;
- iv. mbajtjen e evidencave e të dhënave mbi eksplozivët dhe ofrimin e tyre organeve kompetente;
- v. mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, ofrimin dhe përdorimin e të dhënave në pajtim me këtë ligj;
- vi. bashkëpunimin me organet dhe organizatat ndërkombëtare në aktivitetet e ndërlidhura me eksplozivë;
- vii. kërkimin e informatave rreth shkeljeve të këtij ligji nga organet mbikëqyrëse;
- viii. ndalimin e prodhimit, importit, eksportit, transimit, tregtimit dhe përdorimit të eksplozivëve që behët në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 39

Inspektimi nga Ministria

39.1 Inspektimi i zbatimit të këtij ligji bëhet nga inspektorët e autorizuar të Ministrisë.

39.2 Përmbajtja dhe mënyra e provimit të certifikimit për inspektorët përcaktohet nga Ministria.

39.3 Për përdorimin dhe deponimin e eksplozivëve për nevojat e Minierave inspektimin e bën Inspektori i Minierave dhe në rast të shkeljeve të dispozitave të këtij ligji nga personat përgjegjës të personit juridik i propozon Ministrisë masa ndëshkimore në pajtim me këtë ligj.

Neni 40

Masat Inspektuese

Inspektori i Ministrisë përveç autorizimit të definuar në paragrafin 1 të Nenit 39 dhe autorizimeve tjera të përgjithshme të përcaktuara me këtë ligj, ka të drejtën dhe detyrën për të:

- i. caktuar një afat kohor për eliminimin e parregullsive dhe përkohësisht e ndalon prodhimin tregtimin, ngarkimin, shkarkimin dhe përdorimin e eksplozivëve;
- ii. propozuar organeve kompetente revokimin e licencave për prodhim dhe tregtim;
- iii. kërkuar sqarime me shkrim rreth subjektit të inspektimit nga personat përgjegjës apo personat tjerë;
- iv. paraqit kallëzim te autoritetet kompetente për kundërvajtje ose vepra penale.

Neni 41

41.1 Ankesa kundër ndalesës së përkohshme nga nën paragrafi i. të nenit 40 nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

41.2 Ankesa shqyrtohet nga Ministria brenda 15 ditëve nga dita e pranimit.

Neni 42

Kompetencat e Policisë

Policia bën mbikëqyrjen e tregtimit, importit, eksportit, transitit, transferimit dhe përdorimit të eksplozivëve.

Neni 43

Kompetencat e organeve inspektuese

43.1 Zyrtarët inspektues nga paragrafi 1 i nenit 39 në pajtim me kompetencat e tyre, kanë përgjegjësi të :

- i. ekzaminojnë dokumentacionin e ndërlidhur me eksplozivët, të hyjnë, të kontrollojnë dhe të ekzaminojnë objektet, vend-punishtet, ku prodhohen, deponohen, tregtohen, transferohen, përdoren dhe asgjësohen eksplozivët;
- ii. urdhërojnë eliminimin e parregullsive;
- iii. ekzaminojnë dokumentet të cilat dëshmojnë kualifikimin profesional të personelit;
- iv. ndalojnë përkohësisht aktivitetet në lidhje me prodhimin, tregtimin dhe përdorimin e eksplozivëve, kur kriteret e përcaktuara më këtë ligj nuk përmbushen;
- v. ndalojnë prodhimin, tregtimin dhe përdorimin e eksplozivëve, kur zbulohen parregullsitë e masave të sigurisë;
- vi. ndalojnë përdorimin e eksplozivëve kur kriteret e përcaktuara më këtë ligj nuk përmbushen;
- vii. ndalojnë përdorimin e objekteve të deponimit të cilat nuk i plotësojnë kushtet për deponimin e eksplozivëve;

- viii. ndalojnë prodhimin dhe tregtimin e eksplozivëve, kur përdoret paketim i papërshtatshëm;
- ix. ndalojnë përdorimin e objekteve për deponim dhe objektet për ngarkim dhe shkarkim, kur kriteret e përcaktuara me këtë ligj nuk përmbushen;
- x. urdhërojnë masa të tjera të domosdoshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, mbrojtjen e pronës dhe mjedisit.

43.2 Ankesa kundër çdo mase nga paragrafi 1 i këtij neni nuk e ndalon ekzekutimin e saj.

KREU X

DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 44

44.1 Personi juridik për kundërvajtje dënohet me gjobë në shumë prej 1000 € deri në 7000 € nëse:

- i. nuk e informon stacionin më të afërm të policisë rreth eksplozivëve të vjedhur ose të humbur, sipas paragrafit 8 të nenit 7 të këtij ligji;
- ii. nuk i dërgon evidencat Ministrisë në afatin e caktuar sipas paragrafi 2 të nenit 15 të këtij ligji;
- iii. nuk informon Ministrinë për fillimin ose ndërprerjen e prodhimit sipas paragrafit 1 të nenit 18 të këtij ligji;
- iv. nuk i dërgon evidencat Ministrisë sipas paragrafit 4 të nenit 20 të këtij ligji;
- v. nuk e tregon licencën me kërkesë të zyrtarit të policisë sipas paragrafit 4 të nenit 24 dhe paragrafit 5 të nenit 25 të këtij ligji;
- vi. nuk mban evidenca sipas paragrafit 2 dhe 3 të nenit 37 të këtij ligji.

44.2 Personi juridik për kundërvajtje dënohet me gjobë në shumë prej 5,000 € deri në 15,000 € nëse:

- i. nxjerr eksplozivë në treg ose fillon të përdor eksplozivët para se Ministria ti ketë dhënë pëlqimin dhe udhëzimet për përdorim sipas paragrafit 1 të nenit 8 të këtij ligji;
- ii. prodhon eksplozivë pas skadimit të afatit të licencës në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 14 të këtij ligji;
- iii. bën hulumtime të eksplozivëve në kundërshtim me nenin 17 të këtij ligji;
- iv. nuk posedon dokumentacionin e përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 19 të këtij ligji;
- v. shet eksplozivë në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 20 të këtij ligji;
- vi. i shet eksplozivë një personi pa licencë në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 21;
- vii. transferon eksplozivë në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 25 të këtij ligji;
- viii. është në posedim të eksplozivëve në kundërshtim me nenin 27 të këtij ligji.

44.3 Personi juridik për kundërvajtje dënohet me gjobë në shumë prej 10,000 € deri në 35,000 € nëse:

- i. nuk siguron mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, pronës dhe mjedisit sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 7 të këtij ligji;
- ii. nuk garanton objekte të sigurta fizikisht dhe teknikisht për prodhim, tregtim dhe deponim të eksplozivëve sipas paragrafit 6 të nenit 7 të këtij ligji;
- iii. nxjerr eksplozivë në treg ose fillon përdorimin e eksplozivëve në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 9 të këtij ligji;
- iv. lejon përdorimin e eksplozivëve nga personeli i pakualifikuar në kundërshtim me nenin 12 të këtij ligji;
- v. prodhon eksplozivë në kundërshtim me nenin 13 dhe nenin 14 paragrafin 1 të këtij ligji;
- vi. prodhon eksplozivë në vend-punishte në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 16 të këtij ligji;
- vii. përdorë eksplozivët në kundërshtim me nenin 22 të këtij ligji;
- viii. eksporton eksplozivët në kundërshtim me nenin 23 të këtij ligji;
- ix. importon eksplozivët në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 24 të këtij ligji;
- x. transferon eksplozivë në kundërshtim me kufizimet sipas paragrafit 2 të nenit 26 të këtij ligji;
- xi. nuk siguron mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve sipas paragrafit 1 të nenit 28 të këtij ligji;
- xii. nuk kthen eksplozivët e papërdorur sipas paragrafit 6 të nenit 28 të këtij ligji;
- xiii. asgjëson eksplozivët në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 28 të këtij ligji;
- xiv. asgjëson eksplozivë në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 28 të këtij ligji;
- xv. deponon eksplozivët në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 29 të këtij ligji;
- xvi. lejon që eksplozivët të përdoren nga personel i pakualifikuar në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 34 të këtij ligji.

44.4 Konfiskimi i produkteve eksplozive duhet të urdhërohet si një sanksion dytësor për kundërvajtje të vogla nga nën paragrafët v. dhe viii. të paragrafit 2 dhe nën paragrafit vii. të paragrafit 3 të këtij neni .

Neni 45

45.1 Personi përgjegjës i personit juridik për kundërvajtje dënohet me gjobë në shumën prej 100 € deri në 500 € nëse ai ose ajo:

- i. prodhon eksplozivë në kundërshtim me nenin 13 të këtij ligji;
- ii. shet eksplozivë në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 20 të këtij ligji;

iii. keqpërdor barutin dhe ndezësit si iniciues të municionit për përdorim personal;

iv. është në posedim të eksplozivëve në kundërshtim me nenin 27 të këtij ligji.

45.2 Zyrtari i policisë në pajtim me legjislacionin penal konfiskon përkohësisht produktet nga nën paragrafi iv. i paragrafit 1 të këtij neni në vendin e ndodhjes së kundërvajtjes.

45.3 Konfiskimi i produkteve eksplozive mund të urdhërohet si sanksion dytësor për kundërvajtje nga ky nen.

Neni 46

Personi fizik dënohet me gjobë me shumën prej 100 € në vendin e kryerjes së kundërvajtjes nëse ai nuk e prezanton licencën me kërkesën e zyrtarit policor, sipas nën paragrafit të nenit 36 të këtij ligji.

Neni 47

Dënimet me gjobë të përcaktuara në nenin 45 dhe 46 të këtij ligji nuk e përjashtojnë shkelësin nga përgjegjësia penale dhe përgjegjësitë e tjera.

KREU XI

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 48

Ministria nxjerr akte të veçanta nënligjore që rregullojnë lëmit e posaçme profesionale sipas këtij ligji.

Neni 49

Brenda afatit prej një viti nga dita kur ky ligj hyn në fuqi, poseduesit e licencave duhet ti fillojnë aktivitetet e tyre për mbajtjen e evidencave në përputhshmëri me dispozitat e këtij ligji.

Neni 50

Të gjitha mjetet e realizuara në bazë të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 51
Mbikëqyrja

Mbikëqyrja për zbatimin e këtij ligji bëhet nga Ministria, policia, doganat dhe organet tjera mbikëqyrëse dhe inspektuese, secila në pajtim me kompetencat e veta.

Neni 52

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 53
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-005
16 maj 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI